

V E N D I M
Nr. 508, datë 16.10.2002

**PËR RITJEN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË VETERANËVE TË LUFTËS
ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar", të neneve 21 e 27 të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpërblimi i veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, i përcaktuar në vendimin nr. 190, datë 3.5.1995 të Këshillit të Ministrave "Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar", i ndryshuar, rritet në masën 3.56 për qind.

Konkretisht:

- Shpërblimi sipas shkronjës "a" të pikës 7, nga 2 837 lekë në muaj bëhet 2 937 lekë në muaj.
 - Shpërblimi sipas shkronjës "b" të pikës 7, nga 2 270 lekë në muaj bëhet 2 352 lekë në muaj.
 - Shpërblimi sipas shkronjës "c" të pikës 7, nga 1 891 lekë në muaj bëhet 1 958 lekë në muaj.
 - Shpërblimi sipas shkronjës "e" të pikës 7, nga 567 lekë në muaj bëhet 587 lekë në muaj.
 - Shpërblimi sipas pikës 8/1, mbi 6 muaj, nga 945 lekë në muaj bëhet 979 lekë në muaj.
 - Shpërblimi sipas pikës 8/2 deri në 6 muaj, nga 567 lekë në muaj bëhet 587 lekë në muaj.
 - Shpërblimi sipas shkronjës "a" të pikës 9, nga 2 837 lekë në muaj bëhet 2 937 lekë në muaj,
- plus masën e shpërblimit të invalidit të grupit të parë.

- Shpërblimi sipas shkronjës "b" të pikës 9, nga 1 890 lekë në muaj bëhet 1 958 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas pikës 11, nga 945 lekë në muaj bëhet 979 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas pikës 13, nga 37 830 lekë bëhet 39 177 lekë.

2. Fondi prej 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekësh për mbulimin e shpenzimeve, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, miratuar në buxhetin e vitit 2002.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2002.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano